



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding”, Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit.
- II. 1. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: Prona e paluajtshme në pronësi PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë, me sipërfaqe prej m<sup>2</sup>, pjesa e parcelës kadastrale nr. 153-1, Zona kadastrale, Matiçan, Prishtinë, me destinim banim individual, sipas Planit rregullues “Mati 3”, nr. 01. nr. 35-133, dt. 29.03.2007.
2. Pronat e paluajtshme që merret nga ky këmbim janë: Prona e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, pjesa e parcelës nr. 236-2, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1579m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashani, pjesa e parcelës nr. 234-1, Z.K Çagllavicë Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 81m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, pjesa e parcelës nr. 217-0, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1230m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, parcela nr. 219-3, ZK Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 5650m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-12, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1560m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-10, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1480m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-4, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 898m<sup>2</sup>,  
Prona e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Shefqet Gashit, Shkurte Zeqirit, Mentor Zeqirit dhe Melihate Zeqirit, pjesa e parcelës nr. 1739-39, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 3159m<sup>2</sup>, me destinim për interes publik, infrastrukturë rrugore dhe shkollë, planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.

- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që do të këmben.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmben, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### **Arsyetim**

Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kërkesa nr. 13-463/03-173475/20, dt. 24.09.2020, lidhur me këmbimin e pjesës së parcelaës kadastrale nr.153-1, Zona kadastrale, Matiçan, Prishtinë, në pronësi PSH, Kuvendi Komunal Prishtinë, me pronën e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, pjesa e parcelës nr. 236-2, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1579m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, pjesa e parcelës nr. 234-1, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 81m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, pjesa e parcelës nr. 217-0, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1230m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të “Bau Holding” LLC, parcela nr. 219-3, ZK, Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 5650m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-12, ZK Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1560m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-10, ZK Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 1480m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, parcela nr. 238-4, ZK Çagllavicë, Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 898m<sup>2</sup>,

Pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit, Mexhid Dobrës, Isa Gacaferit, Valdrin Bekës, Vjollca Limanit, Kushtrim Maliqit, Shkurte Rizanit, Shefqet Gashit, Shkurte Zeqirit, Mentor Zeqirit, Mensur Zeqirit dhe Melihate Zeqirit, parcela nr. 1739-39, ZK Çagllavicë Prishtinë, me sipërfaqe për këmbim prej 3159m<sup>2</sup>.



Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim “ në Prishtinë. Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-024/01-114744/21, më 18.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

